

VENDIM
Nr. 72, datë 22.8.2014

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTEVE
PRODHUES TË SHOQËRISË “KOMP. ENERGJI” SHPK PËR HEC-ET “HURDHAS
1”, “HURDHAS 2” DHE “HURDHAS 3” SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “l”, 9 dhe 39, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 3 pika 1 germa “f”, të ligjit nr. 138/2013 “Për burimet e energjive të rinovueshme”, të ndryshuar, nenit 9, pika 1, dhe 2, germa “a” të Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.8.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Komp. Energi” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për kualifikimin e impianteve prodhues të shoqërisë “Komp. Energi” sh.p.k. për HEC-et “Hurdhas 1”, “Hurdhas 2” dhe “Hurdhas 3” me fuqi të instaluar totale 4.21 MW, si burim i rinovueshem energjie,

KONSTATOI SE:

Aplikimi i shoqërisë “Komp. Energi” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregullores së procedurave të certifikimit, prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3, germat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për kualifikimin e impianteve prodhues të shoqërisë “Komp. Energi” sh.p.k. për HEC-et “Hurdhas 1”, “Hurdhas 2” dhe “Hurdhas 3” si burim i rinovueshëm energjie me fuqi të instaluar totale 4.21 MW

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti